

# Oral History Kosovo

---

**Intervistuesja:** Kur je martu ti, në çfarë moshe?

**Narratorja:** Une jom martue '97-tën.

**Intervistuesja:** E sa vjet i ke pasë?

**Narratorja:** I kom pasë 24.

**Intervistuesja:** Edhe qysh vendose m'u martu?

**Narratorja:** Qysh vendosa, e pavendosët jom konë shumë edhe pse na njifshin shumë si, si shumë femra që jena konë të sjellshme, të nalne, të ni familjes të mirë. Shumë jom konë e pavendosët, se kom thonë fat i jetës shumë ka rëndësi a. Në jetën e njerit qekjo ma e rëndësishmja në jetë u konë. Edhe kom thonë ishalla e gjej vet si veten, nashta si veten jo, po përafërsisht, bile si ngat dikun ni djalë që... Po apet s'osht' keq, kryesorja morali osht' mi krejt.

**Intervistuesja:** A ta ka gjetë dikush, a e ke gjetë vet?

**Narratorja:** Shoqja e ngushtë djalë të hallës e ka pasë edhe jo që ku me ditë sa domethonë më ka pëlqy anej-knej, po sjelljet e tina më kanë bo që me dalë me to edhe m'u njoftu e m'u... me fjalë të sajna domethonë.

**Intervistuesja:** A e pate fshtirë me ndrru vendin?

**Narratorja:** Pak po, se pak qytetin e kom dashtë ma shumë, se nashti pak kena hekë me do punë, e ma të angazhum jena konë, për shembull me bari me mledhë, e ato, e ato, a po kupton? Edhe kom thonë që... une isha kështu për pastërti tepër edhe kisha qef veç mrena në shpi m'i gjetë vetit punë, jo jashtë a po kupton? Edhe na u ka dashtë me i mrri krejt punët edhe me dalë jashtë. Edhe kom thonë që me rëndësi është njeri m'u konë, martesë m'u konë tamam, dej diku me gjetë. Po pak qyteti më ka pëlqy ma shumë, se e kom ditë që ma të afrume janë punët, ma së shkurti, po.

**Intervistuesja:** Kallxom, qysh ke ardhë në familje të re, prej familjes tonde?

**Narratorja:** Shumë, shumë rondë e kom përjetu.

**Intervistuesja:** Spjegoma pak.

**Narratorja:** Vallahin une për veti shumë ronë, se na kena pasë respektin. U dashtë shembull m'u çu herët në mëngjes, me bo shërbimin me kafe qata anëtarë krejt.

**Intervistuesja:** Sa kanë qenë?

**Narratorja:** Jena kanë shtatë. Edhe u dashtë shembull...

**Intervistuesja:** Kush ka qenë, spjegoma kush ka jetu me juve?

**Narratorja:** Ka jetue, veç ni kunat s'u kanë me neve atëhere, se krejt na anëtarët e familjes burrit, krejt i ka pasë qaty.

**Intervistuesja:** Vjehri, vjehrra?

**Narratorja:** Vjehri nuk u kanë se s'e kom gjetë, ai kish pasë vdekë ma heret, vjehrra, kunetë, fëmija kunatit, kunata. Tani dikur mas meje u martue, une me 18 maj jom martue, kunata mas vitit ri. Domethonë, edhe krejt komplet jena kanë ni familje qaty. Me fol Zoti mos e boftë, s'ke fol kurrë, pa marrë parasysh pe çka pe, të thotë dikush çka të tha, je bo nija - s'nijta, pashë - s'pashë. Ajo u kanë te unë se nona më ka eduku edhe më ka thonë, "Pa marrë parasysh qysh do qoftë dikush, ti veç me fjalë të mira edhe me respekt m'i ra. Edhe mos me fol". Jo që u kanë edhe koha pak qashtu, po ndërgegjeja s'mi ka leju do sene, hajt se gjithkush e ka për veti edhe une jom qajo që jom, jom rritë në qat familje, që e kom edukatën e familjes edhe nuk muj.

**Intervistuesja:** A të vike fshtirë?

**Narratorja:** Fshtirë. Sot vajza jem shembull më thotë për do sene, shembull që i din kur u rritë e ka kuptue jetën tem deri dikun. Thotë, "Mam qysh ke mujt? Une për veti s'muj duroj. E di që kurrë nuk ke fol. Pa marrë parasysh nashta ta ka lëshu naj fjalë të rondë najkush, nashti të ka ngucë e krejt, ti kurrë nuk ke fol, une nuk muj. Mam të kom, e di çfarë mami të kom, po une për veti nuk muj, s'muj mu durue qashtu". Shembull, po.

**Intervistuesja:** A i bjen pishman që ke qenë qashtu?

**Narratorja:** Jo, për mirë nuk jom pishman kurrë. Nashtë, gjithkush për veti e kem Zotin.